



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 1486/3 prot.

Tiranë, më 29.10.2019

REKOMANDIM

Nr. 49, datë 29.10.2019

**PËR KONTROLLUESIN “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT”**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1, gërma a/1, dhe 32, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, neneve 77-112, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Operatori i Sistemit të Transmetimit”;

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr.263, datë 26.09.2019, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Operatori i Sistemit të Transmetimit” me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi “Operatori i Sistemit të Transmetimit”.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit “Operatori i Sistemit të Transmetimit” konstatoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka “Njoftuar” Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.  
Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21 dhe nenit 22, të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: “...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur

*kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.*

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në rubrikën “*Politikat e Privatësisë*”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi mbi mungesën e politikave të privatësisë, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*” dhe Vendimit nr. 6/2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”.

3. Konstatohet se kontrolluesi informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave “*nëpunës*”, “*vizitorë*”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), por ato nuk janë sipas Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cenimit të privatësisë etj. Sistemi i video survejjimit CCTV përbëhet nga 20 kamera, imazhet e të cilave ruhen për 20 ditë, dhe aksesohen sipas kërkesës vetëm nga personat e autorizuar.
4. Kontrolluesi, nuk ka hartuar rregulla specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, pika 2/1: “*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.*”

Konstatimi përbën shkelje të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, pika 2/1 : “*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera*”.

5. Kontrolluesi ka parashikuar në kontratën standard të punës një dispozitë të veçantë për ruajtjen e konfidencialitetit, e cila është e përgjithshme. Është e nevojshme që punonjësit e departamenteve që përpunojnë të dhëna personale të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit sipas parashikimeve të nenit 28, të ligjit Nr.9887/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, dhe Vendimit nr. 06/2013 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*”.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin e konstatimit, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit deklaroi se: *“Mora në dorëzim procesverbalin. Çdo sqarim i mëtejshëm do të dërgohet në rrugë zyrtare pasi strukturat përkatëse të njihen me këto konstatime”*.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Operatori i Sistemit të Transmetimit”* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 15.10.2019 pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë dhe ka parashtruar këto pretendime:

1. Në lidhje me plotësimin e detyrimit për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22, të ligjit nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, OST nuk ka pasur dijeni për këtë detyrim. Pas ushtrimit të hetimit administrativ është plotësuar *“Formulari i Njoftimit”* dhe është depozituar pranë Zyrës së Komisionerit.
2. Në lidhje me konstatimin mbi politikën e privatësisë, OST me anë të urdhrimit të brendshëm nr.161, datë 25.06.2019 të Administratorit të OST sh.a., me qëllim plotësimin e të gjithë standardeve për mirëfunksionimin e faqes web si dhe atyre të sigurisë, është ngritur grupi i punës për riorganizimin e faqes së internetit të OST sh.a. me qëllim ndërtimin e një strukture të re të website-it zyrtar. Aktualisht ky proces ende nuk ka përfunduar. Megjithatë, edhe pse faqja web është në rikonstruksion, nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit është bërë e mundur të futet një menu e veçantë *“Politikat e Privatësisë”* me qëllim informimin e subjekteve të cilët aksesojnë website-in e OST.
3. Në lidhje me informimin mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), ashtu sikurse konstatohet nga Inspektorët, në ambientet e OST ka tabela informuese që ambienti është i survejuar me kamera, në bazë të rregullave të brendshme të institucionit e konkretisht në bazë të *“Rregullores mbi mënyrën e administrimit të ambienteve dhe godinës së administratës qendrore në OST sh.a.”*. Pas vënies në dijeni nga Inspektorët e KDIMDP për kriteret e Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit, OST ka marrë të gjitha masat e duhura për vënien e tabelave sipas modelit standard të miratuar.
4. Në lidhje me hartimin e rregullave specifike për të dokumentuar masat tekniko-organizative me qëllimi garantimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar, OST është në proces të miratimit të Rregullores tip *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Duke qenë se OST është e rregulluar dhe funksionon si shoqëri tregtare, aktet e brendshme rregullues të shoqërisë miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës i Bordit. Kjo rregullore do të miratohet në mbledhjen e radhës që do të zhvillohet.

5. Në lidhje me deklaratën e konfidencialitetit, në Kodin e Punës, ligji bazë për rregullimin e marrëdhënieve të punës për punonjësit e OST, në pikën 4 të nenit 26 të Kodit të Punës, parashikohet shprehimisht: "4) Gjatë vlefshmërisë së kontratës dhe pas mbarimit të saj, punëmarrësi duhet të ruajë faktet e destinuara të mbeten sekret si: - sekretet e fabrikimit dhe të veprimtarisë, që ai ka pasur dijeni kur ka qenë në shërbim të punëdhënësit". Gjithashtu, nenet 28, dhe 29, të Kodit të Punës përmbajnë rregullime mbi ndalimin e konkurrencës për një periudhë 1 vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies së punës, nëse raportet e punës i kanë dhënë mundësinë punëmarrësit të ketë dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe nëse përdorimi i këtyre sekreteve mund t'i shkaktojë punëdhënësit një dëm të rëndë.

Kodi i Etikes për punonjësit e OST sh.a. përmban parashikime mbi mënyrën e përdorimit dhe trajtimit të informacionit konfidencial nga punonjësit që janë në dijeni të tij (neni 14). Kontrata Kolektive e Punës për punonjësit e OST sh.a. përmban parashikime për ndalimin e punësimit për një periudhë 1-vjeçare në ndërmarrjet/sipërmarrjet që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike, për punonjësit që kanë pasur akses në informacione konfidenciale dhe/ose informacione të ndjeshme tregtare.

Bazuar në problematikën e trajtuar më lart, Zyra e Komisionerit vlerëson ta përmbyll këtë hetim administrativ me akt Rekomandimi. Në nxjerrjen e këtij rekomandimi, Zyra e Komisionerit, ka marrë në konsideratë faktin që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, bashkëpunimin e treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimin e kontrolluesit pas konstatimit të shkeljeve.

Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi "Operatori i Sistemit të Transmetimit", ka pasur në dispozicion kohën e mjaftueshme për të rikuperuar të gjitha shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrative.

Për rrjedhojë, kontrolluesi duhet të mbajë parasysh hartimin e rregullores specifike për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e sigurisë e të dhënave personale, publikimin e rubrikës "Politikat e Privatësisë" në faqen zyrtare [www.ost.al](http://www.ost.al) si dhe të përditësojë "Formularin e Njoftimit" sa herë kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 31 pika 1, gërma a/1, dhe 32, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

#### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Operatori i Sistemit të Transmetimit", të hartojë rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 6/2012 të Komisionerit "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale".

2. Kontrolluesi "Operatori i Sistemit të Transmetimit", në zbatim të nenit 18, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të publikojë një rubrikë për "Politikat e Privatësisë" në faqen zyrtare.
3. Kontrolluesi "Operatori i Sistemit të Transmetimit", në zbatim të neneve 21, dhe 22, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "Formularit të Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit.
4. Kontrolluesi "Operatori i Sistemit të Transmetimit", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2, dhe 39, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 8.10.2019

